



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:078983

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05742137

**P.nr.164/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, sipas gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Albinë Velekincë-Sadiku, në lëndën penale ndaj të pandehurit S... H... nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK), me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av.Avdulla Gashi nga Gjilani, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.274/2024 të datës 20.03.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik të datës 23.05.2024 dhe në prezencë të palëve publikisht shpalli, ndërsa më datën 24.05.2024 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Ndaj të pandehurit S. H... nga i ati B..., e ëma A..., e lindur M..., i lindur më ..... në fsh.Pidiq, Komuna e Gjilanit, me vendbanim në Gjilan në Rr. "...", ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar te Taksi Shaqa, i martuar, baba i dy fe mive, i gjendjes së varfër ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse më datë 17.02.2024, rreth orës 20:10, në Gjilan, rruga „Nëna Terezë”, i pandehuri nga pakujdesia, ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që: derisa ishte duke drejtuar automjetin taxi „Shaqa”, e markës „Shkoda Octavia”, me tabela 06-946-CQ, ka vepruar në kundërshtim të dispozitës ligjore të nenit 53.1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor, duke mos e përshtatur shpejtësinë e automjetit, me kushtet e rrugës – vendbanim, ashtu që të jetë në gjendje ta ndali para çdo pengese të paraqitur në rrugë, ku me të arritur përballë mobilierisë „Siesta”, i dëmtuari ka qenë duke e kaluar rrugën dhe për të shmangur aksidentin, i pandehuri dredhon majtas, hip mbi trotuar, mirëpo nuk mund ta ndal automjetin, ku me pjesën e përparme të anës së majtë, e godet të dëmtuarin – këmbësorin Avdi Leka, i cili ishte duke kaluar rrugën nga ana e majtë në të djathtë, kundrejt lëvizjes së automjetit, ku nga goditja përplaset mbi kapakun e motorit, e më pas në trotuar, me ç ‘rast shkakton aksident trafiku me lëndime trupore, ku i dëmtuari, pëson lëndime të rënda, i cili kërkon ndihmë mjekësore në Spitalin e Përgjithshëm në Gjilan – Emergjencë;

**-me çka ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK**

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 21, 38, 40,42,43,44, 69,70,71,72,79, 107, dhe 188 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 452 të KPPRK-ës.

**E D E N O N**

Të pandehurit ., me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **120** (njëqind e njëzete) ditëve, ashtu që me propozimin dhe me pëlqimin e të akuzuarit si dhe në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me burgim i' u **ZËVENDËSOHET** me dënim me gjobë në shumën prej **700 € (shtatëqind - euro)**, të cilën gjobë është i obliguar ta paguajë në pesë rata pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri i lartshënuar nuk dëshiron ose nuk mundet që ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'iu zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që 1 (një) ditë burgim do t'i llogaritet për çdo 20 euro, të dënimit me gjobë.

**Obligohet** i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20 € (njëzet) euro, dhe për shpenzimet e ekspertizës së komunikacionit 200 € (dyqind- euro), dhe të ekspertizës mjeko ligjore në shumë prej 20 € (njëzet- euro) të gjitha këto në shumë të përgjithshme prej 240 € (dyqind e dyzet- euro), si dhe 20 € (njëzet-euro) për kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës.

**A r s y e t i m**

1.Ecuria e procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.274/2024 të datës 20.03.2024, kundër të pandehurit . nga Gjilani, për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1, të KPRK dhe ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim merititor sipas ligjit.

Në shqyrtimin fillestar të datës 23.05.2024, ishin prezent Prokurori i Shtetit Flamur Halimi dhe të pandehurit . me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare av. Avdulla Gashi, në të cilën seance i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën është akuzuar, dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurve e lartcekur për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohen, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht duke u konsultuar me mbrojtësin e tij se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i

shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri . nga Gjilani, e kanë kryer veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### 4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratës se të pandehurit, e ka shpallur fajtor të pandehurin Sylejman Halimi nga Gjilani, sipas dispozitivit I, sepse ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së ngase veprimet e të njëjtit i përmban të gjitha tiparet e veprës penale dhe se i njëjti është dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se i njëjti e ka pranuar edhe vet.

*Në bazë të nenit 370 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 6 dhe 1 të KPRK-së, rrezikimi i trafikut publik:*

8. Kushdo që shkel ligjin mbi trafikun publik apo transportin rrugor dhe rrezikon jetën e njerëzve apo pasurinë dhe me këtë i shkakton dikujt dëm të konsiderueshëm pasuror ,nëse vepra penale nga paragrafi 6. i këtij neni rezulton me lëndim të rëndë trupor ose dëm pasuror në vlerë prej njëzetmijë (20.000) Euro apo më shumë, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

### 5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit, ka vlerësuar se i pandehuri Sylejman Halimi me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 120 (njëqind e njëzete) ditëve, të zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 700 € (shtatëqind - euro), ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit për të pandehurin, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69 dhe 72 të KPRK-së, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të pandehurit ka shqiptuar dënim nën minimumin e posaçëm, është fakti se të pandehurin e kanë pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, se pranimin e fajësisë e kanë bërë në të gjitha fazat e procedurës penale, se të pandehurin është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, ka premtuar se nuk do të kryej vepra tjera penale, është hera e parë që kanë ra ndesh me ligjin, mosha e tyre. Ndërsa, rrethanë rënduese gjykata ka marrë për bazë shkallën e përgjegjësisë penale rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale dhe mënyrën e kryerjes së kësaj vepre penale pasi që të njëjtit me mosveprimin e tyre kanë cenuar normat morale dhe shoqërore në dhënien e ndihmës personave të cilët gjenden në rrezik për jetë.

### 6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim e shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur sipas nenit 38 të KPRK-së, konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen

dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nën 450 dhe 452 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin t' a detyrojë për t'i paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr. 164/2024, më 24.05.2024**

**Gjyqtari,**

Veli Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.